


Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Nr. 64-610/01-19211/20

Datë, 14.08.2020

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjinnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor **2020/2021**

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjinnaz dhe në shkollën profesionale, për vitin shkollor **2020/21**, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Ekstrakti i lindjes.

Sqarim: Shkolla duhet të krijoj kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë aplikimit të tyre.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet më datën **17-21 gusht 2020**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **24.08.2020**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **24-31 gusht 2020**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|--|-------|---------|
| 1. Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) | (60%) | 60 pikë |
| 2. Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasat 6-9) | (40%) | 40 pikë |
| 3. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaz është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve). | | |
| 4. Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë. | | |

Shih: Vendimin edatës 06.08.2020, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2020-2021

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	ELEKTROTEKNIKË	- Elektronikë industriale - Teknik i informatikës - Instalues elektrik	1 1 1	32 32 24
2.	EKONOMI	- Kontabilitet dhe tatime - Tregti me shumicë dhe pakicë	1 1	32 32
3.	MAKINERI	- Instalues i ngrohjes e klimatizimit e ujësjellësit e kanalizimit - Trafik rrugor - Automekanik - Metalpunues	2 1 1 1	48 32 24 24
4.	JURIDIK	- Juridik administratë dhe shërbime të zyrës	1	32
Gjithsej			11	312

Gjimnazi “Skënderbeu” - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr.inxënësve
1.	Shkenca Natyrore	4	32 4x32=128
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	3	32 3x32=96
	Gjithsej	7	224

Drejtori i DAK
Z. Zahir Doda

